LIGJ
Nr.9762, datë 25.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8782, DATË 3.5.2001 "PËR SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8782, datë 3.5.2001 "Për shoqëritë e kursim-kreditit", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8 fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:
"Emri i shoqërisë së kursim-kreditit në letrat zyrtare, publike dhe në dokumente të tjera të shoqërisë paraprihet nga fjalët "shoqëri kursim-krediti", pas të cilave shkruhet emri i saj dhe numri i regjistrimit, të marrë nga organi i ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve.".

Neni 2

Në nenin 37 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:
"Kryetari i bordit drejtues ka të drejtën e regjistrimit të shoqërisë së kursim-kreditit në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve.".

Neni 3

Në nenin 38 paragrafi i parë shfuqizohet.

Neni 4

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 39

Shoqëritë e kursim-kreditit regjistrohen në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve. Procedurat, afatet e regjistrimit dhe procedura ankimore kundër vendimit, që refuzon regjistrimin e shoqërisë së kursim-kreditit, rregullohen sipas procedurave të parashikuara në ligjin për organin e regjistrimit të subjekteve.".

Neni 5

Në nenin 40 paragrafi i parë, fjalët "gjykatën e rrethit gjyqësor të Tiranës" zëvendësohen me fjalët "organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve".

Neni 6

Në nenin 45 paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:
"Pasi regjistrohen në organin e ngarkuar me ligj të veçantë për regjistrimin e subjekteve, shoqëritë e kursim-kreditit ose unioni duhet të marrin licencë nga agjencia rregullatore, për të vepruar si një shoqëri kursim-krediti ose si një union, para se të fillojnë operacionet e veprimtarisë si një

shoqëri kursim-krediti ose si një union.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2007.

Shpallur me dekretin nr.5386, datë 2.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu